



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QËNDRORE

Nr.1085/7 Prot.

Tiranë, më19/03/2017

V E N D I M

Nr.20, Datë 19/03/2017

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË
SË INFORMACIONIT TË USHTRUAR NË AUTORITETIN E
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Pasi u njoha me Informacionin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, për Auditimin Tematik mbi Prokurimin me Objekt “Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, Pajisje për Stacion të Thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë” në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve, Drejtorit të Departamentit të Auditimit të mësipërm, duke marrë në konsideratë kufizimet e auditimit si rezultat i analizimit të procesit të prokurimit dhe shprehjes me vendimeve nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik (me dy vendimeve) dhe të gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit si dhe qenies në proces gjykimi në Gjykatën e Lartë, në mbështetje të nenit 10, 14 dhe 15 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik mbi Prokurimin me Objekt “Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, Pajisje për Stacion të Thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë” në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga auditimi u konstatua se Autoriteti Kontraktor për prokurimin “Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, pajisje për Stacion të Thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë”, **ka zgjatur procedurat e prokurimit në mënyrë jo të argumentuar duke mos analizuar shkaqet e argumentimeve kontradiktore të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në rastin e s’kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik TCI International.** Zgjatja për më shumë se një vit e një procedure, ka sjellë jo vetëm mungesë të një shërbimi të rëndësishëm për zhvillimin e sistemit kombëtar të monitorimit të frekuencave por shoqërohet edhe me mos përdorimin e fondet publike të vëna në dispozicion, duke ulur ekonomikitetin, efektivitetin dhe eficientësinë e burimeve në dispozicion. Kemi arritur në konkluzionin se pavarësisht se Autoriteti Kontraktor ka qenë i kujdesshëm për të respektuar afatet ligjore në çdo etapë të procesit, futja e procedurës në rrjetën e proceseve gjyqësore të realizuara ndërmjet operatorëve ekonomik, dhe pritja e vendimeve gjyqësore të cilat në variantin më të mirë merren me aspekte procedurale dhe jo në aspektet teknike të cilat do të kishin ndikim në vlerën maksimale që mund të përfitohej nga ky prokurim, ka krijuar hapësira për të vënë në dyshim rezultatin final të kësaj procedure.

Veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar Vendimin nr. 914 ,datë 29.12.2014, Neni 1, të këtyre rregullave dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (më poshtë “APP”), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP. Neni 58 Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. KREU VII Neni 56 Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit..... Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, i cili në Kreun II Neni 8 shprehetTitullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficientësi.

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKEP në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të kryejë analizimin e qëndrimeve të ndryshme që Komisionet e Vlerësimit të Ofertave dhe Shqyrtimit të Ankesave, qëndrime që kanë sjellë në zgjatjen e procedurave për prokurimin “Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, pajisje për Stacion të Thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë”, si dhe të vlerësojë faktorët që kanë çuar në mosveprimin për të kërkuar mosdakordësinë me Vendimet e KPP, lidhur me ankesat e paraqitura për këtë procedurë.

Brenda muajit prill 2017

AKEP në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen të veprojnë me profesionalizëm dhe në mbrojtje të interesave publike në rastin e procedurave të prokurimit duke luajtur një rol aktiv në garantimin e konkurrencës së drejtë dhe përfitueshmërisë maksimale referuar kërkesave cilësore të produkteve dhe mallrave sidomos atyre me specifikime teknike të veçanta.

Në vijimësi

B. MASA ADMINISTRATIVE:

Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar procedurave të Prokurimit Publik me Objekt “Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, Pajisje për Stacion të Thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë” dhe fond limit 83.333.333 lekë pa TVSH zhvilluar gjatë vitit 2016 nga Autoriteti Kontraktor AKEP, rezulton se më datë 21.03.2016 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka s’kualifikuar operatorët ekonomikë “TCI International” Inc. dhe “Synapse ATS” dhe ka shpallur fitues operatorin ekonomik Infosoft Systems.

Operatori ekonomik “TCI International” Inc. është njoftuar se skualifikimi i ofertës është kryer pasi “...nuk përmbush kriteret e përgjithshme, pasi vërtetimet janë jashtë afateve të parashikuara në DST, përkatësisht nuk plotëson kushtet të dokumentit që vërteton pagesën e sigurimeve shoqërore, vërtetimet në lidhje me statusin, detyrimet fiskale si dhe garancinë bankare të sipërmarrësit janë jashtë afatit..”. Në datën 01.04.2016, operatori ekonomik “TCI International” Inc. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij. Në datën 06.04.2016 me anë të shkresës nr.697/3 Autoriteti Kontraktor i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën. Në datën 18.04.2016 operatorit ekonomik ka dorëzuar ankesë pranë KPP me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor. Në datën 02.06.2016, KPP, pasi shqyrtoi në themel ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, mori vendimin nr. 405/2016 duke vendosur:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “TCI International” Inc.
2. Të anulojë vendimin e KVO mbi skualifikimin e ofertës së operatoreve ekonomikë “TCI International” Inc dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Të anulojë vendimin e KVO për “Njoftimin e Fituesit” për operatorin ekonomik “Infosoft System” shpk.

AK ka njoftuar në datën 01.07.2016, Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës, mbi rezultatet e rivlerësimit të KVO në zbatim të Vendimit Nr. KPP 405/2016 duke kualifikuar operatorin “TCI International” Inc.

Në ankesën pranë autoritetit kontraktor datë 06.07.2016 operatori ekonomik “Infosoft System” shpk duke kundërshtuar vendimin e këtij të fundit për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “TCI International” Inc ka ngritur pretendime në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatoreve ekonomikë “TCI International” Inc. me argumentet se “ ... TCI Internacional nuk plotëson specifikimet.

Në datën 08.07.2016 AK ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Infosoft System” shpk për pranimin e ankesës së tij duke argumentuar edhe se “....Komisioni i Shqyrtimit të

Ankesës së operatorit Infosoft Systems përveç pretendimeve të ngritura për mos përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga operatori “TCI International” dhe duke marrë në konsideratë që KVO nuk e ka bërë të plotë vlerësimin për përmbushjen e kushteve teknike nga ky operator, ...

Në datën 11.07.2016, AK ka njoftuar Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës, mbi rezultatet e rivlerësimit të KVO, bazuar në Vendimin nr.1815 datë 08.07.2016 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave duke s’kualifikuar operatorin “TCI International” Inc. Në datën 18.07.2016, operatori ekonomikë ankimues “TCI International” Inc. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë AK duke kundërshtuar vendimin për skualifikimin e ofertës së tij. Në datën 22.07.2016 me anë të shkresës nr.1259/5 AK i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën. Në datën 01.08.2016 operatorit ekonomik “TCI International” Inc.ka dorëzuar ankesë pranë KPP me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor. KPP pas shqyrtimit të ankesës në vendimin Nr. KPP 405/2016 ka kualifikuar operatorin “TCI International” Inc... Sa më sipër, K.P.P. gjykon se arsyeja e mësipërm e skualifikimit konstatuar me iniciativë të vetë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës është në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, për sa më sipër në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e KPP”, të ndryshuar, KPP, njëzëri vendosi të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “TCI International” Inc. Të anulojë vendimin e KVO mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “TCI International” Inc dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.

Pas vendimit vendimin Nr. 405/2016 të KPP, AKEP fillon procedurat e hartimit të kontratës me operatorin ekonomik “TCI International” Inc, procedurë e cilat ndërpriten nga vendimi nr. 3934 datë 26.07.2016 i **Gjykatës Administrative të shkallës së parë** e cila pranon padinë e Shoqërisë “Infosoft System” shpk dhe shfuqizon vendimin. 405/2016 datë 02.06.2016 të KPP sidhe nga **Vendimit** nr. 4167 datë 25.11.2016 i **Gjykatës Administrative të Apelit i cili** lë në fuqi vendimin nr. 3934 datë 26.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë me arsyetim tjetër " Sa më sipër ky kolegji arrin në konkluzionin së vendimi i KVO-së e cila ka shpallur në datën 25.03.2016 fitues Shoqërinë “Infosoft System” shpk. është një vendim i mbështetur në ligj dhe në prova sikundër u arsyetua sa sipër e duhet të lihet në fuqi (“...Operatori ekonomik TCI International nuk përmbush kriteret e përgjithshme, pasi vërtetimet janë jashtë afateve të parashikuara në DST, përkatësisht nuk plotëson kushtet të dokumentit që vërteton pagesën e sigurimeve shoqërore, vërtetimet në lidhje me statusin, detyrimet fiskale si dhe garancinë bankare të sipërmarrësit janë jashtë afatit..”).

Për vendimet e mësipërme KLSH është vënë në dijeni nga AKEP me shkresën nr. 1085/2 datë 07.12.2016.

Nga auditimi i procedurave konstatojmë se Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) pavarësisht se ka qenë i kujdesshëm për të respektuar afatet kohore të përcaktuara ligjërisht për çdo etapë të procesit të prokurimit, ka zgjatur procedurat e prokurimit si rezultat i mos zbatimit të detyrave të strukturave përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit, veprime këto që kanë sjellë mos përdorimin me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike të vëna në dispozicion.

Për sa më sipër i rekomandojmë:

*Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 7 pika 2, 3/a të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojë **Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), të 10 punonjësve si më poshtë:*

- 1) Z. PXo me detyrë Kryetar i AKEP në cilësinë e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor
- 2) Z. DS me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimit të Broadband në cilësinë e anëtarit të Komisionit dhe Vlerësimit të Ofertave
- 3) Z. LK në cilësinë e anëtarit të Komisionit dhe Vlerësimit të Ofertave
- 4) Z. AS në cilësinë e anëtarit të Komisionit dhe Vlerësimit të Ofertave
- 5) Znj. EaD në cilësinë e anëtarit të Komisionit të shqyrtimit të Ankesave
- 6) Znj. IX në cilësinë e anëtarit të Komisionit të shqyrtimit të Ankesave
- 7) Z. GM në cilësinë e anëtarit të Komisionit të shqyrtimit të Ankesave
- 8) Z. SM me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Burimeve të Fundme, Autorizimeve dhe Faciliteteve në cilësinë e anëtarit të Komisionit të shqyrtimit të Ankesave
- 9) Z. LT në cilësinë e anëtarit të Komisionit të shqyrtimit të Ankesave
- 10) Z. MD në cilësinë e anëtarit të Komisionit të shqyrtimit të Ankesave

Auditimi i kryer mbi prokurimin me Objekt “Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, Pajisje për Stacion të Thjeshtë Fiks Monitorimi (SRFMS) në Shkodër dhe Vlorë” në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, vlerësohet si shumë i dobët nga Kryetari i KLSH dhe problematika e trajtuar do të jete objekt auditimi edhe në të ardhshëm.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit IT dhe Investimeve të Huaja.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R